



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.63, datë 08/11/2005

“PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT”

Në mbështetje të ligjit 8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 8, gërma “d”, ligjit nr.9232, dt.13/05/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.53, dt.28/01/2005 “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfutur strehim nga programet e banesave sociale me qera”, pika 3, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë ngritjen e **Komisionit të Strehimit** pranë Bashkisë Tiranë të përbërë nga Kryetari dhe 6 anëtarë, 4 prej të cilëve nga Drejtoritë e Bashkisë dhe 2 anëtarë nga organizata jofitimprurëse, të cilat mbrojnë interesat e grupeve të ndryshme sociale, si më poshtë:
 - Kryetar Drejtori i Shërbimeve Njerëzore
 - Anëtar Drejtorja Juridike
 - Anëtar Njësia e Planit Rregullues
 - Anëtar Drejtorja e Infrastrukturës
 - Anëtar Drejtorja e Administrimit të Aseteve
 - Anëtar Përfaqësues nga ADRIF
 - Anëtar Përfaqësues nga Kryqi i Kuq Shqiptar, Tiranë
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi, Drejtorja e Shërbimeve Njerëzore, Drejtorja Juridike, Njësia e Planit Rregullues, Drejtorja e Infrastrukturës, Drejtorja e Administrimit të Aseteve.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI